



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Komuna e Klinës

Kuvendi i Komunës

01Nr. 060 - 30719 / 22

Klinë,

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e Kuvendit të Komunës së Klinës, mbajtur me datë 24. 06. 2022, në sallën e Kuvendit, nisur nga ora 10:00.

Mbledhjen e rregullt të kuvendit të Komunës e hapi kryesuesi i kuvendit, z. Fadil Gashi. A i përshëndeti të pranishmit në mbledhje dhe ju uroj mirëseardhje. Në emër të kuvendit përshëndeti kryetarin e komunës, drejtoret e drejtive, përfaqësuesit OSBE-së dhe të tjerë. Kryesuesi Gashi konstatoi se prezent janë 24 anëtarë të kuvendit dhe se punimet mund të vazhdojnë. Në lidhje me rendin e ditës ai jua dha fjalën anëtarëve të Kuvendit që të deklarohen.

z. Esat Raci: Përshëndetje. Në lidhje me rendin e ditës në pikën 7-të është raportimi i kryetarit të Komunës për situatën ekonomiko financiare si dhe pani i investimeve në 6-shtë mujorin e parë të 2022. Ne si asamblistë nuk kemi marrur asgjë të shkruar. Pse nuk është sjellë raporti paraprakisht. Gjithashtu për drejtorinë e financave do të doja të ju rekomandoja që pagesat për asamblistët dhe anëtarët e komiteteve të bëhen sepse kemi asamblistë që akoma nuk ka marrë asnjë pagesë.

z. Fadil Gashi, kryesues: Raportimi i kryetarit është vazhdimësi. Bëhet dy herë në vit. Asnjë herë nuk ka ardhur raport paraprak. Kryetari rapporton dhe as nuk ka debat dhe as votim. Për çështjen e dytë do të doja që të na jepet një përgjigje drejtoria e financave.

z. Zafer Gashi: Përshëndetje. Edhe unë rreth pikës së 7-të, me pajtim të asamblistëve, propozoj që këtë pikë ta vendosim në rendin e pikës 4. Arsyë është që ta dëgjojmë kryetarin para se ta kemi pikën e miratimit të kornizës buxhetore. Po ashtu pajtohem me atë që e tha Esat Raci, është dashur që ta kemi paraprakisht raportin e kryetarit por meqenëse ju thoni se ka qenë praktikë e më hershme.

z. Fadil Gashi, kryesues: Unë po kërkoj nga anëtarët e kuvendit që të miratohet rendi i ditës kështu siç është shkruar. Ndryshimet mund të bëhen vetëm me ligj. Gjithsesi propozimi i Zaferit do të qitet në votim.

Rendi i ditës ashtu siç është dërguar paraprakisht u MIRATUA me 15 vota për, 3 abstenime(LVV) dhe asnjë kundër.

Pika 1 e Rendit të Ditës: Arsyetimi i mungesave

Kryesuesi theksoi se për dy anëtarë të Kuvendit ka informim paraprak për mungesën e tyre. Arben Limanaj i cili është jashtë vendi si dhe Bledar Berisha i cili është në trajtim mjekësor.

Pika 2 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar.

Procesverball u MIRATUA pa asnjë vërejtje, me 24 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim

Pika 3 e Rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimeve të KPF-së.

Kryesuesi theksoi se rekomandimet janë dërguar në material përvèç dy kërkesave të cilat janë orientuar tek drejtoritë dhe zyra e kryetarit sipas rregulloreve ligjore. Kërkesat e tjera janë në rend dite dhe nëse dëshirojnë mund të aprovojen në bllok.

Rekomandime u Miratuan me 24 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim.

Pika 4 e Rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i kornizës afatmesme buxhetore 2023-2025.

z. Ajet Sejdiu, u.d. i drejtorit për FEZH: Përrshëndetje të gjithëve. Drejtoria e FEZH duke u bazuar në qarkoren buxhetore ka nisur iniciativën për përpilimin e kornizës në fjalë e cila është obligative sipas ligjeve në fuqi për menaxhimin e financave publike. Menjëherë pas marrjes së qarkores buxhetore, ne kemi përcaktuar hapat që duhet ndërmerrën për hartimin e kësaj kornize afatmesme buxhetore. Hapi i parë ka qenë aprovimi i kornizës afatmesme buxhetore me datë 30 qershor 2022, hapi i dytë: Shqyrtimi i prioriteteve për programet komunale. Hapi i tretë: Kufijtë specifik për programet para datës 1 korrik 2022. Hapi i katërt: dorëzim propozimi i buxhetit komunal sipas programeve. Hapi i 5-të: dëgjimet buxhetore, hapi i 6-të: Përgatitja e dokumentacionit buxhetor. Hapi i 7-të: Shqyrtimi i buxhetit të propozuar komunal nga ana e Kuvendit komunal jo ë vonë se data 1 shtator 2022. Hapi i 8-të dhe i fundit: Aprovimi i buxhetit të propozuar Komunal nga Kuvendi dhe dorëzimi i tij në Ministrinë e financave jo më vonë se sa data 30 shtator 2022. Pra, ne menjëherë kemi filluar nga puna de kemi përcaktuar kalendarin për mbajtjen e dëgjimeve publike të cilat ju informoj se janë mbajtur 10 dëgjime të tilla në 35 fshatra si dhe qytetin e Klinës. Ky proces nuk është ndërprerë, do të vazhdoi deri me datë 30 gusht 2022. Ne si Drejtori i FEZH, kemi analizuar buxhetin dhe kemi dhënë propozime bazuar në qarkoren buxhetore. Po ashtu ju informoi se buxheti për 2023 është për 8.56% më i lartë se sa në vitin 2022. Grandi i përgjithshëm është rritë në 5 milion e 438 mijë në vitin 2023, në vitin 2024 në 5 milion e 849 mijë , në vitin 2025 në 6 milion e 332 mijë euro. Grandi i arsimit ka një rënje të vogël në krahasim me vitin paraprak por përafërsisht vlerat janë të njëjtë. Grandi i shëndetësisë ka një rritje të lehtë në krahasim me vitin paraprak. Të hyrat vetanake kanë rritje gjithashtu. Këto janë parashikimet për vitin 2023, 2024 dhe 2025 . Ju faleminderit.

z. Ndrec Zefaj: Të nderuar të pranishëm, përrshëndetje të gjithëve. S ai përket Kornizës afatmesme buxhetore, dëshiroj që të ndalem tek projektet me prioritet për vitin 2023. Janë kategorizuar të gjitha projektet për vitin 2023 ndërsa vërejtja e ime është se janë përdorur terma të përgjithshme. Kërkoj që në shtator këto projekte të vijnë të specifikuara një nga një. Gjithashtu mendoj që për Bujqësinë qeverisja lokale duhet të ndaj më shumë buxhet. Sidomos duhet të kemi prioritet ndarjen e pajisjeve bujqësore. Vërejtje tjetër më e rëndësishmja është se në këtë dokumentacion nuk është përmendorur Rinia. Në asnjë vit në këtë projekt nuk është planifikuar përkrahja për rininë e Klinës. Duhet të kemi ndarje buxhetore edhe për këtë kategori.

Znj. Besiana Gashi: Të nderuar. Ne si grup kuvendar kemi qenë dhe jemi gjithmonë për investime që janë në të mirë të qytetarëve. Pa dashur që të lëshohem në detaje, ju informoi se grupi ynë do të abstenoj në votimin e kësaj kornize. Janë dy arsyë për këtë vendim tonin. 1. Ne si grup Kuvendar në muajin shkurt të këtij viti kemi bërë një kërkesë për projektet shtator-dhjetor të vitit 2021 dhe jemi

injoruar nga kryetari dhe ekzekutivi. 2. Kemi informata se në takimet që janë mbajtur me publikun janë thirrur vetëm anëtarët e partisë në pushtet.

z. Zafer Gashi: Ne kemi marr një dokument të shkruar por duhet përmirësuar shumë në mënyrë që kur të vije koha për votimin e buxhetit të jemi unik. Kur jemi tek tabelat e këtij dokumenti tek të planifikimi i të hyrave vetanake për periudhën 2023-2025, tek tatimi në pronë, ka shuma të mëdha. Nëse shohim të tjerat si qiraja për treg të hapur, qiraja për banesa, shitja e pasurisë, shfrytëzimi i pronës publike, janë minore në krahasim me të hyrat e tatimit në pronë. Pra, mendoj që këtu duhet të ketë seriozitet më të madh. Kur dalim tek shpenzimet komunale sipas kategorive ekonomike, zyra e kryetarit parashikohet ti ketë për këto vite diku më shumë se sa një milion e 400 mijë euro. Paramendoni sa janë planifikuar për drejtorinë e bujqësisë- më pak se sa për zyrën e kryetarit. Tek projektet që përshihen të realizohen, shtrirja nëpër fshatra lë shumë për të dëshiruar, është shumë e padrejtë. Jelloc, Jashanicë dhe Resnik- për tri fshatra janë paraparë vetëm 100 mijë euro investime. Nëse shohim, në tre fshatra: Sferkë, Volljak, Qupevë, ndërtimi i infrastrukturës rrugore, planifikohen 350 mijë euro investime për këto vite. Ndërkaj dua ta përgëzoj planifikimin për dy fshatra të tjera Zajm dhe Deiq ku janë planifikuar 320- mijë euro investime në infrastrukturë rrugore. Kjo ndarje nuk është e barabartë as sipas tatim paguesve, as numrit të banorëve të këtyre anëve. Në fshatin Sferkë në kohë fushate është bërë diskriminim në disa lagje. Është nda përgjysmë lagija. Kam foto që Burimi është i kontaminuar kompletni, vërtetojeni. Ne kërkojmë që kjo shpërndarje e mjeteve të këtë prioritet sipas nurit të banorëve me nevoja. Fshati Kpuz nuk e kam pa që përmendet në këtë draft buxhet. Pra, kërkoj edhe një herë që të punohet me rishpërndarjen e prioriteteve sipas nevojave të qytetarëve. Ne sot do të abstenojmë, kur te vjen buxheti nëse i merrni parasysh këto vërejtje do të votojmë pro.

z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës: Përshëndetje. Dëshiroj të lidhem pak në lidhje me prioritete e kësja kornize. Këtë vit rruga e parë që ka nisur të shtrohet është rropa Sferkë-Volljak që tani është në procedurat e prokurimit dhe ka vlerën rreth 200 mijë euro. Për Zajm dhe Deiq është menduar që të shtrohet shtresa e re e asfaltit vitin e ardhshëm, të ndërtohet trotuari dhe ndriçimi deri te varrezat e qytetit. Kontrata e vitit të kaluar për Sferkë- Volljak është 100 mijë euro , plus këtë vit 200 mijë euro , d.m.th. 300 mijë euro investime. Shto këtu edhe impiantin e trajtimit të ujërave të zeza që po implementohet nga viti i kaluar, ndërsa këtë vit është rreth 180 mijë euro. Sa i përket fshatrave Ranoc dhe Leskoc është një kontratë e firmosur që tani po e mbështesim me mjete vetanake. Ndoshta ka të drejt Ndreca kur thotë se kemi përfshi nga dy tre fshatra në kod buxhetor. Kjo do të detajohet me projekt gjithsesi. Për planifikimet e buxhetit për zyrën e kryetarit. Duhet ta dini se kryetari nuk i ka ato para përvete. Ky kuvend e ka rregulluar se kush mund të i shfrytëzoi këto mjete. Po ashtu dihet që kjo është një kornizë afatmesme buxhetore që do të kemi mundësi ta rregullojmë dhe plotësojmë. Unë jam shumë mirënjojës nëse angazhoheni të gjithë dhe kontribuoni në këtë kornizë dhe përgatitjen sa më të mirë të saj dhe buxhetin ekzakt për vitin 2023 kur do ta kemi në muajin shtator. Nuk dua të merrem me çdo detaj dhe dilemë që ngritët por për bujqësinë janë 160 mijë euro të parapara për investime kapitale për vitin e ardhshëm dhe po ashtu janë edhe 120 mijë të tjera në subvencione. Draft buxheti ka shuar si i tillë dhe nuk mund të përdorën për tjetër gjë. Do të doja që vitin e ardhshëm të jemi bashkdraftues e formues të buxhetit. Nuk kam asnjë interes politik përvëç se interesin e mirëqenies së qytetarit në përgjithësi.

z. Valmir Bacaj: Përshëndetje të gjithëve. Korniza e afatmesme buxhetore përtej detyrimit institucional komunal buxhetor që ka paraqet edhe dokumentin kryesor mbi bazën e të cilit do të hartohet buxheti për vitin e ardhshëm 2023. Mbajtja e dëgjimeve publike përtej obligimit ligjor tregon edhe një

gatishmëri për të dhënë llogari e kryetarit në këto debate. Kryetari Elezaj çdo herë ka qenë i hapur ndaj kërkesave të anëtarëve të kuvendit, opozitës gjithashtu. Gjithmonë ka qenë bashkëpunues prandaj edhe kësaj radhe propozimet e arsyeshme që vijnë nga ky kuvend do të përfshihen në kornizën afatmesme buxhetore. Sa i përket zyrës së kryetarit tek kategoria e subvencioneve. Këtu janë të përfshira kërkesat e ndryshme. Jemi dëshmitar të shumë kërkesave financiare për shëndetësi dhe nevoja shëndetësore por edhe kategoritë si Rinia, Kultura, sporti dhe Bujqësia. Ne si grup kuvendar do të jemi pro kësaj kornize afatmesme buxhetore pasi që është në të mirë të qytetarëve.

z. Zafer Gashi: këtu u thanë dy gjëra që janë keqkuptuar. Unë nuk jam kundër investimeve në fshatin Zajm e Deiq. Përkundrazi i përgëzova. Kur themi që po ndahen mjete për personat me nevojë dhe sëmundje, jemi dëshmitar që ka me muaj të tërë që kërkesa të tillë nuk janë plotësuar dhe nuk ju kanë nda mjete. Ju lutem të jeni korrekt.

z. Zenun Elezaj, kryetar: Gjitha mjetet janë të destinuara, të ndara, ne nuk kemi mundësi të japid më shumë. Për nevojat që i përmend Zafi janë gjithsejtë 15 mijë euro të ndara, nuk kam asnjë mundësi më shumë të japid prandaj nuk arrijmë që të i plotësojmë të gjitha kërkesat.

z. Valmir Bacaj: Dëshiroj që të sqaroj se kërkesa për ndihma financiare kemi pasur vazhdimisht dhe i kemi ndarë mjete derisa kemi shfrytëzuar komplet buxhetin e ndarë në zyrën e kryetarit. Në asamble kemi dhënë edhe mendime të ndryshme, edhe nga ato që këto kërkesa të mbështeten nga niveli qendror prandaj po them se Zafi ndoshta bënë mirë që të ndikoj në qeverinë qendrore që të ndahan mjete për këto kërkesa.

z. Zafer Gashi: Valmir, profesori është këtu besoi që nuk keni nevojë që ta mbronit sepse ky mbrohet shumë mirë vet. Do të mundohemi që ta plotësojmë këtë dëshirë dhe të kërkojmë nga Albin Kurti që ta rrisë këtë buxhet duke anuluar disa vizita jashtë shteti.

z. Esat Raci: Ne u deklaruam rreth kësaj kornize afatmesme buxhetore. Por më bëri përshtypje thirrja e kryetarit për bashkëpunim. Është e vërtete që kemi marr ftesë nga asistenti i kryetarit për bashkëpunim me ne shefat e grupeve kuvendare por nuk ishin korrekt si shefi i grüpuit kuvendar të AAK po ashtu as nga kryetari sepse ne me këmbëngulësinë më të madhe në mandatin e kaluar kemi kërkuar që në vitin 2020 të listohen vetëm 7 projekte për buxhetin 2021 dhe nuk kemi hasur mirëkuptimin e tyre.

z. Kolë Prenaj: Përshëndetje të gjithë të pranishmëve. Kjo pikë është mjaft kyqe dhe domethënëse. Kërkoi nga grupei kuvendar i PDK-së që ta tërheqin fjalën për mos votim të kësaj kornize. Kërkoi që të jemi unik në këtë pikë sepse është mjaftë e rëndësishme që të votohet nga të gjithë. S'a i përket drejtorive, Drejtoria e arsimit, shëndetësisë dhe bujqësisë janë mjaftë të ndjeshme. Këto drejtori duhet at kenë një vizion dhe qellim se në çka do të investohet konkret. Kjo kornizë është interes për të gjitha komunitetet, grupet dhe individët që jetojnë në Klinë. Duhet të jetë sa më profesionale edhe pse drejtorët mund të mos janë të lëmive përkatëse me profesion por të bashkëpunojnë me ekipe dhe individ profesionist që janë në kuadër të drejtorive por edhe jashtë administratës. Nuk do të doja të shoh diversitet por unitet, prandaj lus grupet Kuvendare që u deklaruan për abstenim që të ndryshojnë qëndrim.

z. Esat Raci: Dua të ja kujtoj z. Prenaj se grupei ynë kuvendar në asnjë rast nuk ka deklaruar që nuk e përkrahin Kornizën. Kemi thënë që çdo investim në të mirë të qytetarëve e kemi përkrahur dhe do ta

përkratim por këtë kornizë afatmesme buxhetore do të abstenojmë dhe juas treguan arsyen shumë çartë.

z. Enver Gashi: Përshëndetje. Të gjitha projektet i përkrahim dhe mendoj që janë të shpërndara mirë. Duke e lexuar dhe shikuar këtë kornizë afatmesme buxhetore dhe duke i ditur nevojat e qytetarëve, si i deleguar i qytetarëve në këtë Kuvend dua të ndalem tek bashkësia më e madhe në Komunën tonë që është ajo e Sferkës. Kërkoi që të shtohet vlera e projekteve në 150 mijë euro për vitet 2023-2025 në BL e Sferkës. Po ashtu kërkoi që të bëhet ndarja në kode të projekteve në këto fshatra.

z. Tunë Dedaj: Përshëndetje. Unë e pash që kornizën afatmesme buxhetore në ndonjë fshat ka investime më të mëdha por e diji që në ato fshatra që është paraparë të investohet më shumë nuk është investuar në të kaluarën, prandaj konsideroj që është kornizë e mirë dhe i ftoj të gjithë anëtarët e Kuvendit që ta votojnë për.

z. Fadil Gashi, kryesues: Kjo është kornizë që deri në finale do të mund të pësoj ndryshime. Po më vjen mirë që kemi filluar të diskutojmë më shumë se sa për një rrugë të asfaltuar, më shumë se sa për një lagje. Qëllimi është që resurset që i kemi të i shfrytëzojmë mirë duke ngritur mirëqenien tonë. Nuk jam i kënaqur me pjesëmarrjen e qytetarëve në debate të këtyre çështjeve. Do të doja që qytetarët të mobilizohen për pjesëmarrje në këto takime dhe të janë vendimmarrës. Ju ftoj të gjithëve që të votoni.

z. Ndrec Zefaj: Kushtimisht do ta votojmë këtë kornizë ne si grup kuvendar i LDK-së më qellim që vërejtjet tona të merren në konsiderim kur të përgatitet definitivisht buxheti.

z. Fadil Gashi, kryesues: Ne i kemi të përcaktuara linjat buxhetore, Në këtë kuvend i kemi votuar për me i ndryshuar duhet që të i votojmë prap në Kuvend.

Kryesuesi e vuri në votim dhe me 16 vota për, 8 abstenime dhe asnjë kundër U MIRATUA

Pika e 5 e Rendit të Dities: Shqyrtimi dhe miratimi i propozitivit vendimit për transferimin e mjeteve nga kategoria rezervë.

z. Ajet Sejdiu, U.D. i FEZH: Ne kemi bërë një përmirësim në bazë të kërkesës së marrur nga ministria e Financave për harmonizim me ligjet për menaxhimin e financave. Janë mjete rezervë që duhet të barten në disa projekte të tjera ashtu siç janë propozuar.

Kryesuesi e lexon arsyeshmerinë e dhënë nga drejtoria e FEZH pasi që nuk kishte asnjë diskutim, ai e vënë në votim dhe me 24 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA

Pika 6 e Rendit të Dities: Shqyrtimi dhe aprovimi i vendimit për lirimin nga qiraja për vitin 2020 dhe 2021 të kategorive të dala nga Lufta dhe banuesit social.

Kryesuesi theksoi se në KPF është shqyrtuar ky vendim dhe nuk janë pajtuar. Ai ja jep fjalën u.d. të drejtorit të FEZH.

z. Ajet Sejdiu, u.d. i drejtorit të FEZH: Kërkesa është bërë nga ne, drejtoria e FEZH. Vetëm për sqarim lista e parë që ju është dërguar juve, nuk është më, d.m.th. është hequr. Banesat e zyrtarëve publik si dhe të ish udhëheqësve politik nuk përfshihen në këtë falje borgji. Janë vetëm kategoritë e dala nga lufta dhe kategoritë sociale, ky është propozimi ynë dhe komisioni i formuar nga kryetari i Komunës. Janë grumbulluar mjete të mëdha borgje nga këto kategori dhe edhe kërkesa e tyre është që të ju japim një ndihmë.

- z. Fadil Gashi, kryesues:** Na e lehtësove tani sepse në komitet ka qenë ndryshe. Aty kam qene edhe unë në listë për lirim nga borgjet e që kam qenë kundër.
- z. Kushrim Haliti:** Përshëndetje. Unë në listën e qiramarrësve i kam pa dy mera aty që e kanë dorëzuar banesën qysh para vitit 2017, Sokol Bashota dhe Enver Berisha. Tani në listën e re i paskan heq. Dua ta dijë pse ata emra figurojnë akoma nëpër lista. Dhe pyetja e dytë, kush janë përfituesit e atyre dy banesave dhe pse nuk janë emrat në liste të atyre që i akne marr ato banesa prej vitit 2018?
- z. Ajet Sejdiu, u.d. i Drejtorit të FEZH:** Pyetjen e njëjtë ma ka bërë edhe anëtari i kuvendit Bledar Berisha. Dua të ju sqaroj se ata emra mbisin si shënimë të kontabilitetit që ne nuk kemi guxuar të i fshijmë por që tani i kemi hequr dhe nuk do të figurojnë më.
- z. Kushtrim Haliti:** Unë pyeta për përfituesit e këtyre dy banesave të dorëzuara. Kush janë ata dhe a kanë borgje.
- z. Ajet Sejdiu, u.d. i drejtorit të FEZh:** Po janë Kushtrim. Njëri është Sokol Gashi dhe tjetri nuk po më kujtohet emri por është në listë.
- z. Zafer Gashi:** Dua të juaj bëjë me dije që Lëvizja Vetëvendosje është pro faljes së borgjëve për këto kategori për periudhën që është përcaktuar. Por kërkojmë që sot të largohet kjo pikë nga rendi i ditës sepse këtu kam rekomandimet që i ka dhënë KPF dhe në muajin tjetër të vijë kjo listë pasi të analizohet dhe kontrollohet mirë. Aty ka emra të personave që ju ka rregullua gjendja ekonomike, ka emra aty që banesat e marrura i akne dhënë me qira më shuma të tjera nga ato që i paguajnë komunës. Pra, ta kemi një filtrim të banuesve të këtyre banesave të dhëna nga komuna si arsyë e gjendjes së tyre të rëndë ekonomike. Pasi të filtrohen ne jemi dakord që të ju falen borgjet e të shikohet mundësia që të ju falen borgjet edhe për vitin 2022. Besoj që kam përkrahjen edhe të grupeve të tjera kuvendare për këtë propozim.
- z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës:** Që ta ndihmoj pak procesin. Unë mendoj që duhet të ndahen këto dy vendime. Kemi edhe kërkesën e auditorëve për ndërhyrje në këtë proces. Atë që e propozoj Zafi, ide e mirë pse jo të shohim në vazhdim. Propozimi im është që ne të marrim një vendim sot sipas propozimit që është bërë që ta ndihmojmë procesin sipas rekomandimeve të auditorëve. Seancën e ardhshme të bëhet një rekomandim i kuvendit për vazhdimin e kontratave sepse unë e kam problem me juaj vazduhar kontratat edhe për 10 vjet e ardhshme. Pra të shkohet me këtë draft propozim dhe në takimet e ardhshme të bisedojmë gjithçka që është në interes të qytetarëve.
- z. Valmir Bacaj:** Pajtohem i me propozimin që e dha kryetari tani. Pak a shumë është i njëjtë me propozimin që kemi bërë si KPF. Në seancën e ardhshme të marrim raportin e komisionit dhe të vazhdojmë tutje.
- z. Esat Raci:** Edhe ne si grup kuvendar pajtohem i me këtë propozim që është dhënë. Kemi pasur takim me shoqatat e OVL dhe edhe ata janë dakord që të shkohet në bllok e mos të ketë ndarje sa i përket kësaj kategorie.
- z. Zafer Gashi:** Edhe ne do ta votojmë por jemi humb këmbëngulës që në seancën tjetër të vije drafti i filtruar siç e propozova.
- z. Zef Ndrecaj:** Edhe ne si grup kuvendar pajtohem i me propozimin e dorëzuar.

z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës: Të dallohet përfituesit zyrtar publik. Fjala është për objektin e veteranëve dhe objektet e kategorive sociale. Zyrtarët publik përjashtohen nga ky vendim për lirim.

z. Zafer Gashi: Dëshiroi ta diji nëse objekti i ashtuquajtur i kariqave a është objekt social?

Kryesuesi i Kuvendit dhe kryetari i komunës theksuan se ai objekt është në mbikëqyrje të Habitatit, nuk është objekt i kategorive sociale.

z. Tunë Dedaj: Në të ardhmen nuk është mirë të shkohet në këtë mënyrë sepse po favorizohen disa grupe. Veteranët kanë nevojë të lirohen vërtetë por nëse ata janë në punë dhe marrin të ardhura nuk kisha thënë të lirohen. Ata që janë veteranë dhe janë në punë, unë do të thoja që ata përveç rrogës të marrin edhe 170 euro shtesë sepse janë veteranë, mos të ju ndalet ajo pjesë. Drejtoria është mirë që në të ardhmen ai që i ka kushtet edhe nuk e paguan qiranë të i qoj te përmbaruesi edhe me juva marr mjetet. Kësaj radhe do ta votoj pro.

z. Fadil Gashi, kryesues: Pajtohem. Drejtoria disi lehtë po e kalon, po preton me shkuar te përmbaruesi dhe me i marr mjetet. Pavarësisht kategorisë, ne jemi të përkushtuar me ju ndihmuar atyre që kanë nevojë. Edhe një herë për me qenë edhe për proces të saktë edhe për vendim: lirohen nga qiraja për atë periudhë kohore kategoritë në objektin e veteranëve dhe në objektet sociale.

z. Shemsedin Berisha: Përshëndetje për të gjithë. Unë dëshiroj vetëm një sqarim ta kemi. E pash që në listat përfalje të qirasë ka persona që kanë borgj shuma të mëdha pa paguar, atyre do të ju falen, por disa të tjerë kanë më pak. Si do të ju bëhet atyre që kanë paguar dhe janë në këto kategori – lista. Gjithashtu, ata që kishin borgje të mëdha në kontratën e dytë që do të ju bëhet është mirë të bëhet një planifikim se si do të arrijnë ata në pikën zero borgje.

z. Ajet Sejdiu, u.d. i drejtorit të FEZH: Vendimi që merret sot duhet të jetë i barabartë për të gjithë. Ata që akne paguar do të kalojnë në parapagim ndërsa ata që kanë borgje të mëdha dhe nuk paguajnë jemi të detyruar që të i dërgojmë te përmbaruesi kjo edhe me rekondimin e auditorit.

z. Zenun Elezaj, kryetar i komunës: Në vendimin e ardhshëm për vazhdimin e kontratave të shfrytëzimit do ta vejmë kusht programimi i likuidimit të borgjeve sipas drejtorisë së financave, paraprakisht.

z. Valmir Bacaj: A ka mundësi edhe një herë të dimë se çka po votojmë. A po votojmë që të ju falen vetëm atyre që janë në objekte sociale dhe në objektin e veteranëve apo gjitha kategorive sociale e veteranëve që banojnë në objekte të tjera të komunës të dhëna me qira atyre?

z. Fadil Gashi, kryesues: Gjithë atyre të kategorive sociale dhe veteranëve pavarësisht në cilin objekt a banesë të dhënë nga komuna me qira banojnë. Përveç zyrtarëve publik që nuk ju falet borgji.

Kryesuesi e vene në votim dhe me 24 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA

Pika 7 e Rendit të Ditës: Raporti i kryetarit të Komunës për situatën ekonomike financiare të komunës dhe zbatimit të planeve investuese për gjashtë mujorin e parë të vitit 2022.

z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës: Po e pranoj si një sugjerim të mirëqenë faktin që në raportimet e tjera të ju përgatis vullnetarisht raportin paraprakisht. Edhe pse kjo ka qenë praktikë e deri tanishme dhe se gjitha këto që unë do ti them tani do të evidentohen dhe shkruhen në procesverbal. Ky vit është një vit sfidues, edhe ne si komunë jemi në një situatë të rendë me rritje të çmimeve. Problemi kryesor është tek kontratat e nënshkruara në vitin e kaluar dhe që vazhdojnë edhe këtë vit. Operatorët

ekonomik i kanë ndaluar punimet në shumë raste shkaku i kësaj rritjeje dhe është goxha e vështir me i bindë ata që të punojnë me humbje. Ne nuk kemi mundësi me i rrit vlerat e atyre kontratave. Takimin e fundit e kam pasur këtë të mërkure ku pjesa dërmuese e tyre kanë shpresë në qeverinë për rritjen e vlerave të kontratave. Kemi gjetur një pajtueshmëri për ato kontratat të cilat po realizohen por shumë pak po punohet. Është e vështir që ata të vazhdojnë punimet e shtrimit të asfalti kur vitin e kaluar çmimi i një centimetër asfalt ka qenë 8 euro ndërsa këtë vit është 16 euro. Betoni, hekuri dhe të tjera. Kemi pritur rishikimin e buxhetit nga qeveria. Ky rishikim ka ndodhë mbrëmë por se kam parë se çfarë ka në atë buxhet të rishikuar. Operatorët shpresojnë që ka me pas rritje të vlerave të kontratave në atë buxhet. Unë kam kërkuar nga të gjithë operatorët ekonomik që deri me datën 1 korrik, maksimumi deri me 10 korrik të ma dëshmojnë mundësinë e vazhdimit të kontratave me dakordimin e të gjithëve, eventualisht ne do të procedojmë me shkëputje të kontratave dhe të gjitha [pasojat që vijnë bazuar në ligjin e prokurimit publik. Këto janë për projektet që janë edhe në web të komunës të publikuara. Ndërsa projektet e këtij viti, vlera e planifikuar është 425 mijë e 541 euro. Vlerat e kontraktuara janë 365 mijë e 195 euro, deri me tanë. Ndërsa vlerat e proceduara dhe iniciuara janë 1 milion e 733 mijë e 400 euro, që d.m.th., përafersisht deri në këtë fazë ne i kemi kaluar nëpër procedurat e prokurimit pothuajse të gjitha projektet e planifikuara. Të gjitha procedurat e prokurimit, na kanë ardhur ofertat më të mëdha se sa planifikimet buxhetore të bëra dhe na është dashur që të i anulojmë procedurat, të i zvogëlojmë para masat dhe të i rishpallim prap. Të gjitha janë rishpallë përsëri por kemi pasur edhe disa rezerva buxhetore që i kemi ridestinu në projekte të caktuara. E dij që jemi të vonuar në planifikime, nuk ka pasur neglizhencë nga ana jonë por ka pasur probleme në proces si pasojë e krizës ekonomike. Besoj që edhe në javën e ardhshme dhe do të shpallen të gjitha projektet e planifikuara me buxhetin e vitit 2022. Do të mobilizohemi dhe do të kërkoj nga operatorët ekonomik që ta përshpejtojnë planin e veprimit dhe të jemi në kohë duke plotësuar edhe një nga kriteret për përfomancën e mirë komunale që është shpenzimi i 75% të buxhetit vjetor. Unë i kam të listuar të gjitha projektet dhe që mos të ju marr kohë këtu duke i lexuar do të jua dërgoj të gjithëve një raport plotësues në ditët në vijim.

Disa projektet ndërlidhen me donatorë të ndryshëm, siç janë projektet e ujit, që kanë fatin e njëjtë më ato që i përmenda më herët pra fatin e krizës ekonomike. Kam informata se me presionin e bërë nga fondacioni zviceran CDI, operatori ekonomik i ka intensifikuar punimet dhe ka marr hapat të nevojshëm pasi që është edhe në finalizimin e projektit, ka porositur pompat e duhura dhe tanë kanë mbetur vetëm edhe rezervuarët dhe aty këtu ndonjë punim kanali për vendosjen e gypave, që është lajm i mirë gjithsesi. Faleminderit shumë të gjithëve për durimin, jam i gatshëm për çdo shqetësim tuajin.

Pika 8 e Rendit të Ditet: Shqyrtimi i vendimeve sipas shkresës të dërguar nga MAPL dhe Ministrisë së mbrojtjes së mjedisit, planifikimit hapësinor

Kryesuesi theksoi se është fjala për disa shkresa që nuk po arrijmë të kemi mirëkuptim me ministrinë e linjës. Kanë kërkuar nga ne që të i rishikojmë, ne i kemi rishikuar dhe jua kemi dërguar përsëri, nga MAPL prap kanë pasur vërejtje e kështu nuk po arrijmë të gjemë mirëkuptim duke u detyruar që të i anulojmë të gjitha natyrish me pajtimin edhe tuajin. Propozimi im është që të i anulojmë të gjitha vendimet e rishqyrtuara që kanë të bëjnë me vendimin bazë.

z. Tunë Dedaj: Ne po marrim vendim për disa çështje që janë të rëndësisë së veçantë. Nuk e dij si mund ta dinë ata të ministrisë më mirë se sa 27 anëtarë të kuvendit për një çështje të rëndësishme tonën.

z. Fadil Gashi, kryesues: Për me qenë më të saktë për çka bëhet fjalë, është vendimi që kemi marrur për planin e veprimit në shërbimet e ekosistemit dhe investimet inteligjente në Komunën e Klinës. Dhe

vendimi i dytë është ndarja e sipërfaqes për ndërtimin e objektit të zjarrfikësve në pronë të komunës. Është hera e parë që ata të ministrisë e qesin më të rëndësishëm shfrytëzuesin se sa pronarin. Kërkojmë edhe nga kryetari i komunës edhe nga zjarrfikësit që të gjejnë hapësira dhe mundësi tjera. Sa përikujtum, ne si kuvend edhe stacionin e policisë e kemi vendosë në atë hapësirë. Njëjtë edhe përvendimin e parë, shumë e çuditshme është. Krejt plani i veprimit është që të mbrohet ambienti ndërsa ata nga ministria na e kthejnë me arsyen se duhet të mbrohet ambienti. Nuk po jua marr kohën më shumë.

z. Zafer Gashi: Ne në detaje nuk jemi të informuar për arsyet me shkrim që i kanë dhënë nga ministria por më të vërtetë vendimi për ndarjen e parcelës duhet goxha shumë me u arsyetuar para se me na e kthyer negative. A e kemi sqaruar mirë ne gjitha këto që i the më herët, që është pronë e komunës dhe që objekti i zjarrfikësve aktual është në gjendje që nuk i plotëson kushtet. Është mirë që të bëhen këto sqarime.

z. Fadil Gashi, kryesues: Ne po humbim grande për shkak të këtyre vonesave. Nëse nuk ka diskutime të tjera unë po e qes në votim.

Me 19 për , tre abstenime dhe asnjë kundër, ANULOHEN vendimet.

Pika 9 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi i raportit të punës së KKSBB për aktivitetet e zhvilluara në 6-shtë mujorin e parë të vitit 2022.

Znj. Marqe Selmani, nënkyetare e Komunës: Faleminderit kryesues. Përrshëndetje të gjithëve. Kemi arritur me mbajt një mbledhje të KKSBB shkaku i rizgjedhjeve të reja të anëtarëve të KKSBB si dhe shkaku i pandemisë. Rezultatet e arritura janë të evidentuara në këtë raport. Gjithashtu edhe objektivat që synohen të arrihen. Nëse ka dikush për të pyetur për detaje, jam këtu për tu përgjigjur.

z. Esat Raci: Në 6-shtë mujorin e fundit, gjendja e sigurisë në Komunën e Klinës nuk ka qenë e mirë. Jemi dëshmitarë të humbjes së jetës së njerëzve dhe uroj që mos të ndodhin raste të tillë.

Znj. Marqe Selmanaj, nënkyetare e Komunës: Në mbledhjen e fundit komandanti i Policisë ka raportuar për rastet e ndodhura dhe urimit i bashkohem edhe unë.

Pika 10 e Rendit të ditës: Pyetje dhe Përgjigje

Znj. Blerina Gashi: Kam dy pyetje për dy nga drejtorët. Drejtorin e Urbanizimit: Është hera e dytë që e bëjë këtë kërkesë, fjala është për problemin e ujërave të zeza në fshatin Qupevë e që drejtori herën e kaluar ka premtuar që do të zgjidhet ky problem deri në muajin qershor. Nuk është vetëm ky problem në këtë fshat, mungon edhe ndriçimi publik, prandaj dëshiroj ta pyes drejtorin- Pse fshati Volljak e ka ndriçimin publik ndërsa fshati Qupevë si fshat paraprak nuk e ka? Cila është arsy e këtij dallimi mes këtyre dy fshatrave?

z. Enver Berisha, drejtor i urbanizmit: Përrshëndetje. Po përgjigjem shkurt se projekt i kanalizimit në ato shtëpia e kemi menduar ta vendosim vitin e ardhshëm. Ai projekt të jetë 1000 metra dhe të lidhet me impiantin e Volljakut.

z. Qendrim Millaku, drejtor i SHPE: Përrshëndetje. Nëse është dikush që ka punuar pa dallime politike në nivel të Kosovës është kryetari i Komunës. Edhe fshatit Qupevë do të i vije radha që të instalohet ndriçimi publik. Jemi duke punuar për instalimin e ndriçimit publik në të gjitha fshatrat.

z. Ajet Sejdiu, u.d. i FEZH: Për pagesën e Komiteteve, komisioneve lirisht mund ta formoni një komision nga Kuvendi. E dij që janë disa anëtarë të komiteteve që nuk janë paguar. Ejani dhe e shihni që ne i kemi dërguar kërkesat për pagesë në ministri. DO të jemi këmbëngulës që ta rregullojmë këtë çështje duke përsëritur në vazhdimësi kërkesën për pagesë në Ministri.

Znj. Marigona Raci: Edhe unë kam një pyetje për drejtorin e Urbanizmit. Në fshatin Siqevë një pjesë nuk është e kyçur në kanalizim sepse qytetarët janë të shqetësuar. Kur do të bëhet kjo? Po ashtu për drejtorin e SHPE: Pse nuk ka ujë në fshatin Siqevë, pse nuk funksionon ujësjellësi?

z. Enver Berisha, drejtor i urbanizmit: Sa e kujtoj operatori që i ka ndërpre punimet shkaku i krizës së çmimeve të rritura, do të filloj përsëri në pjesën që ka mbetur në Siqevë.

z. Qendrim Millaku, drejtor i SHPE: Për më saktë do të kem mundësi që të t'ap përgjigjen në seancën e ardhshme, për ujësjellësin në Siqevë.

z. Enver Gashi: Kemi tre pyetje. Për drejtorin e shëndetësisë- Është një shqetësim i qytetarëve për AMF në Sferkë, nuk ak mjek fare që një kohë të gjatë, pse ndodhë kjo? Për drejtorin e Shërbimeve publike- Kur do të përfundojnë punimet në impiantin e Sferkës? Dhe pyetja e tretë prap për drejtorin e SHPE- Pse gjysma e Sferkës nuk ka ndriçim publik?

z. Agron Bacaj, drejtor i Shëndetësisë: Drejtoria e Shëndetësisë është në fazën e rekrutimit të tre mjekëve. Dy i kemi rekrutuar javën e kaluar. Me 15 korrik fillojnë procedurat për rekrutimin edhe të tre mjekëve të tjerë. Siç e dini edhe ju, kemi vështirësi goxha të mëdha në sigurimin e stafit shëndetësor. Ministria e shëndetësisë ka ndërprerë kontratat javën e kaluar për 15 punëtor shëndetësor. Ne jemi duke bërë përpjekje që të i funksionalizojmë të gjitha AMF-të, në këtë kuadër edhe qendra e mjekësisë familjare në Sferkë do të funksionalizohet dhe mjeku do të kujdestaroj brenda mundësive që QKMF do të ketë për të transferuar mjekë nëpër këto QAMF dhe AMF.

z. Qendrim Millaku, drejtor i SHPE: Punimet janë duke vazduhar tek impianti por me ritëm më të ngadalësuar dhe besoi që këtë vit përfundon. Ndërsa për ndriçimin publik, ka pasur probleme shkaku i motit të ligë, janë djegur siguresat. Kemi shpallur tenderin përfundim dhe riparim dhe do ta rregullojmë. Gjithashtu bëjë apel tek qytetarët që mos të i mbulojnë censorët e ndezjeve automatike të dritave kur bëhet natë sepse po mbesin dritat ndezur edhe ditën.

z. Kushtrim Haliti: Kam një pyetje për drejtorin e SHP. Ka lidhje me ndriçimin në rrugën "Ilir Merturi" ka disa muaj që ndriçimi nuk funksionon aty. Po ashtu për drejtorin e Urbanizmit- është një rrugë në lagjen mbi stacion e cila ka rrëshqit para zgjedhjeve. Ju e keni vendosur një muri mbrojtës por edhe muri ka rrëshqit. Para disa ditëve është rrotulluar një traktor shkaku i asaj rruge. Një pyetje tjetër – Në fshatin Jashanicë e Epërme, gjatë fushatës, në rrugën "Xhavit dhe Adem Kamberi" e keni hequr shtresën e shtruar nga fshatari, shtresën e betonit 10 cm me armaturë në gjatësi 80 metra, me qellim që të shtroni asfalt por akoma nuk e keni bërë prej atëherë dhe sot e asaj dite ai nuk po mundet me hy as në oborr të vetin kur ka reshje. Edhe sa i përket drejtorit që tha se nuk është punuar sipas përkatësisë politike, jua bëjë me dije që lagjen Balaj e keni lënë përgjysmë me ndriçim në Gllarevë, Keni instaluar ndriçimin publik në kohë fushatë vetëm tek votuesit e partisë tuaj.

z. Qendrim Millaku, drejtor i SHPE: Nuk kam informacione përrugën "Ilir Merturi", ndërsa sa i përket votave, ju duhet ta dini se ne jemi 50% dhe ngado që të shkojmë, jemi 50%.

- z. Kushtrim Haliti:** 50% është edhe lëvizja vetëvendosje në nivel qendoror por as ata s' po punojnë asgjë.
- z. Enver Berisha, drejtor i urbanizmit:** Inderuar Kushtrim, unë e shoh këtu në shënimet e mijë që aty në atë rrugë në Jashanicë të epërme nuk kanë përfunduar punimet. Është një operator që ka me i shtruar 270 metra rrugë për ti shtruar. Me rifillimin e punimeve ajo rrugë do të rregullohet. Sa i përket rrugës mbi stacion të trenit, ka dy muaj që kemi investuar aty. I kam vizituar ato rrugë dhe është e vërtetë që ka lëviz edhe muri që thatë. Do të vazhdohet me analizë të asaj zone dhe të bëhet zgjidhje e përhershme. Ajo zonë është zonë e lëvizshme.
- z. Asdren Ramadani:** Pjetje për kryetarin. Ura e këmbësore në lagjen Rastoka ka një vit e gjysmë që ajo urë ka mbetur e shkatërruar në tërsësi. Shumë herë kam bërë kërkesa për këtë por asgjë. Kur do të bëhet rregullimi i kësaj Ure? Po ashtu për drejtorin e SHP: Ndriçimi në rrugën e gjimnazit ka dy muaj që nuk funksionon, kur do të rregullohet?
- z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës:** Po Asdren ajo urë është e para parë dhe kontraktuar. Kemi pasur pak probleme pronësore qysh e din edhe ti vet. Kompania projektuese është detyruar që të vendosë pilotë dhe sivjet jemi futur në krizën e çmimeve por pas datës 10 korrik do të fillohet dhe prioritet është edhe ajo Urë.
- z. Esat Raci:** Qëllimi i kësaj pike të rendit ët ditës dihet. Kërkoj nga drejtorët që të vijnë më të përgatitur për pyetjet e asamblistëve e jo të bëjnë deklarata politike në vend të përgjigjeve. Mos të lëshohen në këso deklarata.
- z. Zafer Gashi:** Do të jem i shkurtër. Në emër të LVV falënderojmë drejtoreshën e Kulturës. Jeni për çdo lëvdatë për organizimin e festivalit folklorik "I këndojmë Lirisë"
- znj. Fatjona Gashi, drejtoreshë e DKRS:** Faleminderit të zotri dr. Zafer Gashi për komplimentin për organizimin e festivalit. Dëshiroj të ndërlidhem me fjalën që tha asamblistja Besiana Gashi kur tha se në dëgjime publike po marrin pjesë njerëzit politik të Aleancës. Ne shumë të freskët e kemi festivalin dhe 18 qershorin ku pjesëmarrja e grupit tuaj politik ka qenë e munguar. Pra, sa i përket jetës kulturore, dëshirë e imja do të ishte që të jemi bashkëpunues dhe pavarësish subjekteve politike, të marrim pjesë në organizimet kulturore që i bënë drejtoria e jonë.
- z. Tunë Dedaj:** kam një pyetje për drejtorin e SHP, z. Qendrim Millaku- Gjysma e fshatin ka ndriçim publik në fshatin tim e gjysma jo.
- z. Qendrim Millaku, drejtor i SHPE:** Faleminderit. Esatin po e kaloj nuk po i përgjigjem sot. Inderuar Tunë, aty në fshat është një pjesë e ndriçimit publik që ne për të tretën herë po e paraqesim kërkesën në KEDS që të e instaloni orëmatësin. Dritat janë po presim vetëm orëmatësin dhe të lëshohen dritat.
- Znj. Liria Gashi:** Të nderuar të pranishëm. Kam dy kërkesa. Kërkesa e parë ka të bëjë me ndriçimin publik në fshatin Çabiq, banorët e këtij fshati e kërkojnë ndriçimin publik. Unë kërkoj që në të gjitha fshatrat të instalohet ndriçimi publik. Kërkesa tjetër është, rruga në fshatin Dollc. Rruga "Heronjtë e Kombit", një pjesë e madhe e rrugës është vetëm me zhavorr dhe gropë pa asfalt, shumë shtëpi nuk janë të lidhura me kanalizimin por edhe ai kanalizim është i bllokuar dhe nuk qarkullon.
- z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës:** Lidhur me ndriçimin dua të theksoi se kontratën ekzistuese duhet ta mbyllim. Kjo kontratë e ka fatin e të gjitha kontratave. P.sh. Operatori është i interesuar të vendosë drita dhe kabillo por jo shtylla sepse për shtylla ka lëvizur çmimi. Tani ne si ta mbyllim këtë kontratë do të

nism procedurat për kontratë të re për zgjerimin e ndriçimit në komunën e Klinës, të i rrisim vlerat e kontratave dhe jemi gjithsesi të interesuar dhe kemi planifikimet që komplet në territorin e Klinës rrugët kryesore ta instalojmë ndriçimin publik. Tek rruga në Dollc, kompania është duke bërë matjet dhe kemi diskutuar për modalitetet e ndërtimit të kanalizimit. Një lajm dua të juaj se jemi përfitues të një grandi për ndërtimin e trotuareve në hyrje të qytetit. Gjithsesi që edhe ajo pjesë e Dollcit do të përfshihet në priorititet tonë.

Kryesuesi pas kësaj pike të Rendit të Ditës i shpalli të mbyllura punimet e kësaj seance duke i falënderuar të gjithë për pjesëmarrje dhe kontributin e dhënë.

Procesmbajtës:

Skënder Behramaj



Kryesuesi:

Fadil Gashi

